



MBI 600 EVENTE ARTISTIKE GJALLËRUAN VENDIN GJATË MUAJVE MAJ-SHTATOR

Mbi 600 evente kulturore dhe artistike, kanë pasuruar ofertën turistike të vendit dhe kanë gjallëruar ekonominë lokale duke ofruar mundësi të reja për sipërmarrësit vendas, duke rritur punësimin e të rinjve, si dhe duke vendosur kulturën në zemër të zhvillimit ekonomik. Krahasuar me vitin e kaluar, numri i eventeve të organizuara gjatë muajve Janar - Shtator 2024, ka pësuar një rritje prej 150%. Po ashtu, vetëm nga financimet e projekteve artistike e kulturore që sollën argëtim për mbi 500 mijë spektatorë, janë gjeneruar 5 mijë paga mujore.

TUR TAKIMESH ME PENSIONISTËT E VENDIT PËR SKEMËN E PENSIONEVE



Skema e re e pensioneve dhe plani për të luftuar informalitetin në punë, u diskutua me Kryeministrin dhe me pensionistët, gjatë një ture të hapur në qytete të ndryshme të vendit. Për të përmirësuar situatën, qeveria ka ndërmarrë hapa të rëndësishme, si rritja e ndjeshme e pagave në sektorin publik dhe rritje të të ardhurave, për të hyrë tashmë në një fazë të re kundër deklarimit fiktiv e tolerancës zero ndaj informalitetit.

SHQIPËRIA NË QENDËR TË VËMENDJES NË BIG EVENT PARIS

Zv. Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Sokol Duma, përfaqësoi vizionin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në Big Event Paris, organizuar nga BPI France (Banka Publike e Investimeve), ku u diskutuan tema kyçe për inovacionin dhe ekonominë kreative në Evropë. Gjatë MasterClass-it me temën "Ndërthurja e Kulturës dhe Inovacionit në Shqipëri", Z. Duma theksoi potencialin e madh të industrisë kreative në Shqipëri, që mund të sjellë 600-700 milionë euro të ardhura dhe të krijojë 70-80 mijë vende pune në vit.



NJË TJETËR GUR KILOMETRIK NË BASHKËPUNIMIN 36-VJEÇAR GJERMANO-SHQIPTAR



Me një mbështetje financiare prej 93.39 milionë euro, ku 33.39 milionë € janë grante dhe 60 milionë € kredi me interes të ulët, u nënshkrua në Berlin Protokoli i Bashkëpunimit me Gjermaninë për vitet 2025-2026. Mbështetja financiare do të jetë për një gamë të gjerë sektorësh si në: energji, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, arsimin profesional, bujqësinë, klimën si dhe mbështetjen në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Pjesë e delegacionit shqiptar në Berlin për bisedimeve dhe negociata të cilat ishin intensive, ishin Zëvendësministret e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Znj. Olta Manjani dhe Znj. Blerta Rama.

FORUMI I BIZNESIT SHQIPËRI-GREQ: VENDI JONË NË NJË STAD SHUMË TË MIRË EKONOMIK

Në Forumin e Biznesit Shqipëri-Greqi, ku u theksua rëndësia e bashkëpunimit me Greqinë për të fuqizuar lidhjet ekonomike dhe për të krijuar mundësi të reja për investime, tregti, biznes dhe zhvillim të përbashkët në rajon. Vendi ynë është në një stad shumë të mirë ekonomik, që dëshmohet edhe nga Progres Raporti dhe çelja e negociatave me BE-në, si edhe nga përmirësimi i vlerësimit nga Moodys. Zgjerimi i urave lidhëse dhe sinergjia midis dy vendeve është prioritet kyç, si një e mirë për popujt tanë, mirëqenieje direkte dhe zhvillimi ekonomik.



“ZËRAT E KULTURËS”, ARTI PAMOR NË ZEMËR TË DIALOGUT

Seria e sesioneve "Zërat e Kulturës" për muajin tetor nisi me artistët pamorë, të cilët ndanë perspektivat e tyre mbi sfidat dhe mundësitë që hasin në punën e tyre krijuese. Gjatë këtij takimi ata shprehën po ashtu edhe nevojat, për t'u angazhuar në diskutime të rëndësishme dhe për të formësuar të ardhmen e artit pamor në dialog me institucionet kyçe.





ENKELEJD MUSABELLIU EMËROHET ZV. MINISTËR I MEKI

Z. Enkelejd Musabelliu, është emëruar nga Këshilli i Ministrave si Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Me një karrierë si ekonomist politik me eksperiencë të gjatë në çështjet e zhvillimit ekonomik, planifikimit strategjik dhe politikat sociale, ai ka një përvojë të gjatë dhe të rëndësishme në sektorin publik, si në institucione qendrore ashtu edhe në pushtetin vendor. Angazhimet e tij nuk janë ndaluar dhe në një sërë organizatash ndërkombëtare.

MEKI PJESË E MINISTERIALIT TË KE-SË ZHVILLUAR NË MAQEDONINË E VERIUT



Shqipëria mori pjesë në takimin e ministerialit të Komisionit European për Platformat Drejtuese të Ballkanit Perëndimor mbi Edukimin, Trajnimin, Kërkimin, Inovacionin dhe Kulturën që u zhvillua në Shkup, të Maqedonisë së Veriut. Delegacioni shqiptar i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit u fokusua në temat më të rëndësishme të momentit për inovacionin në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin profesional. Gjithashtu gjatë këtij takimi u diskutuan programet transformuese si “EU4Innovation” dhe zhvillimi i Strategjisë 3S të Specializimit Smart.

MBAHET MBLEDHJA E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS PËR VITIN 2024

Gjatë muajit tetor, u mbajt mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar të Punës për vitin 2024, ku u trajtuan çështje të rëndësishme për tregun e punës, mbështetjen për të rinjtë dhe sfidat për sigurimet shoqërore. Në fokus të këtij takimi ishte edhe marrëveshja e Sigurimeve Shoqërore me Italinë ku u prezantua me detaje, duke theksuar përfitimet që do të sjellë për qytetarët shqiptarë që punojnë në Itali dhe anasjelltas. Gjithashtu u bë një prezantim i Skemës së Garancisë Rinore, e cila ka filluar të pilotohet dhe pritet të zbatohet deri në vitin 2027, si dhe u diskutua mbi Reformën e Sigurimeve Shoqërore. Këto hapa janë të rëndësishme për përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e mundësive për të rinjtë dhe mbrojtjen sociale për të gjithë qytetarët.



FRANCA DHE SHQIPËRIA ZHVILLOJNË TAKIMIN E PARË PËRGATITOR TË KËSHILLIT TË INOVACIONIT

Zv. Ministri i MEKI, Z. Sokol Duma, zhvilloi në Ministrisë e Ekonomisë, Financës dhe Industrisë së Francës, takimin e parë përgatitor të Këshillit të Inovacionit Francë-Shqipëri. Ky takim që u realizua në kuadër të Marrëveshjes G2G të firmosur mes dy vendeve, ka për qëllim zbatimin e projekteve strategjike për zhvillim profesional dhe teknologjik, që përgatit Shqipërinë për anëtarësimin në BE. Gjatë takimit, u diskutua edhe realizimi i një konference nga Banka Publike e Investimeve të Francës në Tiranë dhe u dakordësa për mbajtjen e Këshillit të parë të Inovacionit France-Shqipëri në kryeqytetin tonë në fillim të vitit të ardhshëm.



MBI 1 MILION VIZITORË NË SITET KULTURORE GJATË JANAR - SHTATOR 2024



Kalatë madhështore, muzetë plot histori, e deri tek parqet arkeologjike magjepsëse, janë vizituar nga Janari në Shtator nga mbi 1 milion vizitorë, 35% më shumë se sa një vit më parë. Nga destinacionet, numrin më të lartë të vizitorëve e ka pasur kalaja e Gjirokastrës me rreth 200 mijë, për tu pasuar nga Parku Kombëtar i Butrintit me rreth 128 mijë dhe ndjekur nga Muzeu “Gjergj Ktastrioti” në Krujë, me rreth 100 mijë vizitorë.

MEKI PJESË E PANELIT TË KONFERENCËS SË 9-TË NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË PENALE



Zëvendësministrija e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, znj. Lira Pipa, ishte pjesë e Konferencës së 9-të Ndërkombëtare të Drejtësisë Penale me temë “Faktorët Ekonomikë Nxitës të Lidhur me Migrimin e Rinisë Shqiptare”. Teksa theksoi rëndësinë e kulturës në uljen e migrimit, gjatë këtij takimi, zëvendësministrija fokusoi vëmendjen në pasurimin e jetës kulturore në zonat rurale dhe qytetet e vogla, duke inkurajuar përfshirjen e të rinjve në aktivitete kulturore dhe sociale. Po ashtu, fokus të veçantë ajo i dha edhe rëndësinë e nxitjes së punësimit lokal dhe zhvillimit të turizmit kulturor, si dhe bashkëpunimin me diasporën për të forcuar lidhjet me Shqipërinë dhe artistët shqiptarë.



RRITEN INVESTIMET E HUAJA NË SHQIPËRI GJATË TJANAR - QERSHOR 2024

Në gjashtëmujoin e parë të vitit 2024, Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri kanë pasur një rritje të qëndrueshme dhe të rëndësishme. Këto investime janë fokusuar kryesisht në sektorët strategjikë si aktivitetet e pasurive të paluajtshme që përfaqëson 24.1% të fluksit total. Sektorë të tjerë ekonomikë me një kontribut të lartë në IHD janë sektori i Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit me 16.8%, si edhe Industrisë nxjerrëse, Industrisë përpunuese dhe i Energjisë elektrike, gazit, dhe furnizimit me ujë. Fluksi i investimeve të huaja në vend është dominuar nga Turqia e cila ka kontribuar me 19.5% në fluksin total, e ndjekur nga Italia dhe Holanda të cilat kanë kontribuar me 12.4% dhe 8.1% dhe më pas nga Franca dhe Austria me përkatësisht 7% dhe 6.6%.

JEHONA VARFI DREJTUESJA MË E RE E CIRKUT KOMBËTAR

Znj, Jehona Varfi është emëruar drejtoresha e re e Cirkut Kombëtar. Drejtimi i Cirkut Kombëtar nga ana e saj pritet të sjellë një frymë të re dhe kreative, duke i dhënë një platformë më të gjerë artistëve të rinj dhe për të ngritur institucionin në nivelin që ai meriton, me një kalendar të pasur ëuror e bashkëpunime rajonale, si dhe në rritjen e kapaciteteve njerëzore. Varfi është diplomuar në Trashëgimi Ëurore nga Universiteti i Prishtinës në vitin 2010 dhe ka ndërtuar një karrierë të pasur në fushën e menaxhimit kulturor dhe rinor.



ZBULOHEN PIKTURA MURALE NË KISHËN E MANASTIRIT TË SHËN KOLLIT



Piktura murale janë zbuluar në Kishën e Manastirit të Shën Kollit në Mesopotam të Delvinës, monument ëure i stilit bizantin. Pikturat murale që u zbuluan në këtë objekt, më herët kishin qenë të mbuluara nga llaçi dhe lyerjet me gëlqere. Zbulimi u bë i mundur në kuadër të projektit “Studimi për konservimin e pikturës murale, elementeve dekorative me mermer të arkitekturës dhe dyshtemenë e kishës bizantine”, në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet MEKI dhe Qendrës Evropiane për Monumentet Bizantine dhe Post Bizantine.

ZV.MINISTRI I MEKI Z. SOKOL DUMA NË KONFERENCËN E INOVACIONIT E PROGRESIT

Zv.ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Z. Sokol Duma mori pjesë në Konferencën e Inovacionit dhe Progresit: Rritja e Gjurmës së Shqipërisë në Ekonominë Digjitale Rajonale, që bashkoi në Tiranë liderët kryesorë të biznesit dhe qeverisë për të diskutuar sfidat dhe mundësitë e së ardhmes digjitale në Shqipëri. Gjatë fjalës së tij, Duma foli për përpjekjet e përbashkëta midis sektorit publik dhe privat që janë kyçe për ta kthyer Shqipërinë në një hub inovacioni, digjitalizimi dhe dije, nëpërmjet përpjekjeve të bashkërenduara me biznesin dhe botën akademike.



“ZËRAT E KULTURËS” ME ARTISTËT E ARTIT SKENIK

Aktorë, regjisorë dhe profesionistë të tjerë të fushës së artit, në takimin e radhës së serisë “Zërave e Kulturës”, diskutuan për sfidat dhe mundësitë në fushën e teatrit dhe arteve skenike në Shqipëri. Teksa ndanë eksperiencat e tyre dhe adresuan vështirësitë në prodhimin e shfaqjeve dhe nevojat për mbështetje financiare, theksua edhe rëndësinë e edukimit artistik për brezat e rinj, zhvillimin e dramaturgjisë, nevoja për një infrastrukturë më të mirë, si dhe koordinim mes teatrove, ministrisë dhe pushtetit vendor. “Zërat e Kulturës”, bashkë-organizuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe United Nations Association Albania, do të vijojë takimet me qëllim përfshirjen e zërave të artistëve në vendimmarrje për çështjet e Kulturës. dihmojë që ky diskutim të jetë kuptimplotë dhe i frytshëm!



ISH-SHTËPIA E USHTARAKËVE NË MAT DO STREHOJË 35 FAMILJE NË NEVOJË

Ish-shtëpia e Ushtarakëve në Mat, e ndërtuar në vitin 1970 dhe e shfrytëzuar nga Ushtarakët deri në vitin 1990, do të rikonstruktohet totalisht në kuadër të Programit Kombëtar të Strehimit, për të strehuar 35 familje në nevojë. Mes këtyre familjeve, përfshihen të moshuar, gra kryefamiljare dhe familje me ndihmë ekonomike. Ky projekt jo vetëm që ofron strehim, por edhe ambiente rekreacioni për shërbime sociale dhe për një jetë komunitare më të mirë.



“ZËRAT E KULTURËS”, LIBRAT E LETËRSIA NË ZEMËR TË DIALOGUT KULTUROR

Pjesë e ciklit “Zërat e Kulturës”, ishte edhe një takim kushtuar problematikave të librit dhe promovimit të letërsisë shqipe. Në këtë sesion të radhës organizuar më 21 tetor, bëri bashkë autorë, botues, përkthyes dhe librarë, të cilët diskutuan sfidat e sektorit dhe shqyrtuan mundësitë për rritje dhe përmirësim. Gjithashtu, u trajtua dhe rëndësia e promovimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare, si brenda vendit ashtu dhe jashtë.



DIGJITALIZIMI SI ÇELËS PËR RUAJTJEN DHE PROMOVIMIN E TRASHËGIMISË



Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me Sekretariatit Ekzekutiv të CEI-së, organizuan workshopin ndërkombëtar: “Digitization, Access, and Protection in the Cultural Heritage Sector”. Gjatë takimit u theksua rëndësia e digjitalizimit si një çelës për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë ëurore në Shqipëri. Temat kryesore përfshinin gjithashtu risitë e politikave, mjetet ligjore për mbrojtjen e aseteve ëurore, angazhimin e komunitetit dhe integrimin e teknologjive të reja në dokumentacionin e trashëgimisë. Ky takim ofroi po ashtu mundësi të reja për bashkëpunim në fushën e trashëgimisë ëurore, duke nxitur zhvillimin rajonal dhe turizmin e qëndrueshëm.

MBAHET PËR HERË TË PARË SLUSH'DTIRANA, NJË EVENT I RËNDËSISHËM PËR INOVACIONIN



Tirana Slush'D është event i parë i këtij lloji në Shqipëri, një aktivitet që synon të mbështesë themeluesit dhe të transformojë ekosistemin e startup-eve. I frymëzuar nga formati i njohur “Slush”, ky aktivitet sjell në qendër inovacionin dhe ndërlihd sipërmarrësit shqiptarë me Ballkanin, Diasporën, Europën dhe vendet nordike.

TOLERANCË ZERO NDAJ INFORMALITETIT!

Planifikimi i Inspektimeve nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore me bazë risku ka sjellë përmirësime të ndjeshme, duke identifikuar një rritje prej 29% të punëmarrësve informalë gjatë proceseve inspektuese, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023.


Janë futur në skemë 1,984 punëmarrës informalë, nëpërmjet masës urgjente “Pezullim Aktiviteti”, duke kontribuar direkt në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me një vlerë minimale prej 22,141,440 Lekë pas deklarimit në buxhet.

Plani i inspektimeve do të intensifikohet në vijim dhe toleranca ndaj informalitetit do të jetë zero.



LUFTA KUNDËR TRAFIKIMIT TË PASURIVE KULTURORE, MBAHET SEMINARI 5 DITOR

Në kuadër të projektit “Lufta kundër trafikimit të jashtëligjshëm të pasurive kulturore në Ballkanin Perëndimor”, u mbajt në vendin tonë seminari pesë-ditor për ngritjen e kapaciteteve për kategori të ndryshme të partnerëve kryesorë institucionalë në Shqipëri. Projekti ka si objektiv kryesor të nxisë bashkëpunimin rajonal, pajtimin dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore përmes trashëgimisë dhe kulturës, si parakushte thelbësore për përparimin në rrugën evropiane, dhe veçanërisht nxitjen e përafrimit të kuadrit ligjor kombëtar me atë të BE-së.



ZBULOHEN PORTRETE E FIGURA SHENJTORËSH NË KISHËN E SHNA NDOUT NË KEPIN E RODONIT

Punimet për konservimin dhe restaurimin e pikturës murale në Kishën e Shna Ndout në Kepin e Rodonit, kanë nxjerrë në pah disa portrete dhe figura shenjtorësh. Punimet në këtë monument të trashëgimisë kulturore me një arkitekturë romaniko-gotike e shek. XIV, konsistuan në konsolidimin e shtresave përgatitore dhe pelikulit piktorik, pastrimin nga mbivëniet me gëlqere dhe llaç, pastrimin nga kripërat si dhe zëvendësimin e bordurimeve dhe stukimeve të vjetra. Piktura murale e kësaj kishe bashkë me atë të Kishës së Shëlbuemit në Rubik ishin fokus i programit të EU4Culture.

INAUGUROHEN PUNIMET RESTAURUESE TË HAMAMIT MESJETAR TË DURRËSIT

Hamami Mesjetar i Durrësit ka rihapur dyert për vizitorët e shumtë pas punimeve restauruese. I gjendur pranë Kullës Veneciane, ky objekt me vlera historike dhe ëurore, është një nga 15 sitet e trashëgimisë së vendit tonë që janë rinovuar plotësisht përmes programit ‘EU4Culture’, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNOPS.

